



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PAKR.nr.103/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Tonka Berishaj kryetare, Have Haliti dhe Xhevdet Abazi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Kimete Veseli si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.S. për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë si dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit A.S. av. M.H., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-DKR, P.nr.35/14 të dt.03.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.04.2020, mori këtë:

AKTGJYKIM

I.Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore DKR në Mitrovicë-DKR, P.nr.35/14 i datës 03.02.2020, vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin plotësues, ashtu që Gjykata e Apelit, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 par.1 KPK-së, për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, dënimin komulativ me gjobë në shumë prej 200 euro, si dhe dënimin e zëvendësimit e dënimit me burgim prej 6 muajsh në dënim me gjobë në shumë prej 2000 euro, e që gjithsejtë duhet të paguaj shumën prej 2200(dymijë e dyqind) euro, e merr si të vërtetuar, kurse të akuzuarit i konfiskohet edhe vetura e markës “Audi 80” me numër të shasisë WAUZZZ89KAO4978887, viti i prodhimit 1988 me targa të regjistrimit, si mjet me të cilin është kryer vepra penal.

II.Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

Ar sy e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - DKR, P.nr.35/14 të dt. 03.02.2020, i akuzuari A.S. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 euro.

Kryetari i trupit gjykues me pëlqimin e të akuzuarit ia ka zëvendësuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muajsh, në dënim me gjobë në shumë prej 2000 euro, ashtu që i akuzuari është obliguar që shumën e përgjithshme prej 2200 euro të dënimit komulativ ta paguaj në afat prej 1 muaji nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mos pagesës së dënimit me gjobë në afatin e caktuar gjykata do të ia llogarisë 20 euro për një ditë të kaluar në burg.

Të akuzuarit i ka shqiptuar dënim plotësues konfiskimin e substancës narkotike Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) në peshë të përgjithshme prej 16.35 gram (sipas Ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me nr. ref AKF/2014-0114/2014-96 e dt. 31.01.2014) si dhe 4 holla (rizlla) për mbështjelljen e substancës narkotike, substanca narkotike dhe hollat (rizllat) pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohen.

Është urdhëruar lirimi dhe kthimi i sendeve si në vijim: Automjeti i markës “Audi 80” me numër të shasisë WAUZZZ89KAO4978887 viti i prodhimit 1988 me targa të regjistrimit të lëshuara nga Republika e Kosovës, certifikata e regjistrimit të automjetit si dhe çelësi i veturës, sende të sekuestruara me datë 06.01.2014, automjeti si dhe gjitha dokumentet tjera përcjellëse dhe çelësi i veturës të cilat janë pronë e të pandehurit A.S. sipas aktakuzës së Prokurorisë, automjeti në fjalë ti kthehet pronarit- të akuzuarit A.S. pronari i sendeve të lirohet nga të gjitha shpenzimet eventuale të shkaktuara lidhur me transportin, mbajtjen dhe mirëmbajtjen e sendeve gjatë kohës nga sekuestrimi e deri te lirimi i tyre, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar urdhërohet të zbatojë këtë urdhër pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale 20 euro, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro si dhe shumën prej 50 euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal me propozim që të ndryshohet aktgjykimi sa i përket vendimit mbi dënim të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër dhe ti konfiskohet mjeti i markës Audi 80, certifikata e regjistrimit si dhe çelësi i veturës.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit A.S. av. M.H. me propozim që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i butë dhe të njoftohet për seancën e kolegjit.

Prokurori i Apelit me parashtrësën PPA/I nr.107/20 të dt.25.02.2020, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe aktgjykimi të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me burg efektiv dhe të konfiskohet automjeti, ndërsa të refuzohet përgjigja në ankesë e mbrojtësit të akuzuarit A.S. av. M.H..

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, për shkak se kemi të bëjmë me aktgjykimin e ankimuar në të cilën i akuzuari është dënuar me të holla, palët nuk janë njoftuar për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të prokurorit, të mbrojtësit të akuzuarit së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë, është e bazuar vetëm sa i përket dënimit plotësues, të konfiskimit të veturës.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kjo gjykatë të njëjtin e vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit .

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, se me ankesë nuk mund të kontestohet konform nenit 383 par. 2 të KPPK-së, se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë, kryetari i trupit gjykues është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo gjykatë e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore përkitazi me shkeljen e ligjit penal dhe vendimin mbi dënimin.

Prokuroria në ankesë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e ligjit penal kur të akuzuarit ia ka liruar automjetin, pasi që nuk është kontestuese se i akuzuari automjetin e ka shfrytëzuar për bartjen e substancës narkotike- kanabis, pasi që e njëjta ka qenë e vendosur në 11 qese najloni, përfshirë këtu edhe kutin e vogël të rrumbullakët në brendi të së cilës kishte substancë narkotike-kanabis dhe rizlla për mbështetjen e substancës narkotike në derën e automjeti, kurse se sasia e vogël e narkotikut nuk nënkupton se duhet liruar automjeti sepse atëherë shtrohet pyetja se përse i akuzuari nuk e ka vendosur substancën në trupin e tij por në automjet.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e ligjit penal kur të akuzuarit ia ka liruar veturën, me të cilin i akuzuari e ka bartur substancën narkotike, sepse vetura ka qenë mjeti me të cilin është bartur substancën narkotike, e sipas nenit 273 par.5 të KPRK-së, substanca narkotike, mjetet për prodhim, shpërndarje apo transportim të saj konfiskohen, ashtu që kjo gjykatë bazuar në dispozitat ligjore ka vendosur që të akuzuarit të ia konfiskoj automjeti i markës “Audi 80” me numër të shasisë WAUZZZ89KAO4978887 viti i prodhimit 1988 me targa të regjistrimit, si dhe sende të sekuestruara me datë 06.01.2014, se substancën narkotike ishte gjetur në derën e automjetit .

Lidhur me vendim për dënim Prokuroria konsideron se gjykata ka shqiptuar dënim të butë dhe jo adekuat me ligjin, sepse ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese, duke mos marrë parasysh rrethanat rënduese dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, kufijtë e dashjes së tij dhe se veprat penale të kësaj natyre janë të shpeshtuara.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit ku si rrethanë rënduese ka vlerësuar se nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar më shumë se gjashtë vite, se i akuzuari ka pranuar fajësinë, se ka qenë në moshë të re në kohën e kryerjes së veprës penale, bashkëpunimin e përgjithshëm me gjykatën, shprehjen e keqardhjes, prind i dy fëmijëve, premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, se nga të dhënat e siguruara nuk figuron se është i dënuar më parë, se ka leje dhe vendqëndrim dhe punë të përkohshme në shtetin e Norvegjisë për të cilën e ka dëshmuar me Leje Qëndrimit me nr. HC0163508.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat siç parashihen me dispozitat e nenit 73 të KPK-së, rrethanat lehtësuese që i ka marrë parasysh gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit, për të akuzuarin si pranimin e fajësisë dhe keqardhjen e shfaqur, kanë kaluar më shumë se gjashtë vite nga kryerja e veprës penale, se ka qenë në moshë të re në kohën e kryerjes së veprës penale, bashkëpunimin e përgjithshëm me gjykatën, është prind i dy fëmijëve, premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, se nuk ka qenë i dënuar më parë, i aprovon edhe kjo gjykatë, kurse prokuroria në ankesë nuk ka cekë rrethana tjera rënduese që do të ndikonin që të akuzuarit të i shqiptohet dënim me burgim efektiv, ashtu që kjo gjykatë duke marrë parasysh faktin se tani i akuzuari edhe jeton në Norvegji, konsideron se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është në funksion të preventives gjenerale dhe të asaj individuale dhe në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarit, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 403 të KPPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR 103/2020 datë 17.04.2020

Procesmbajtëse,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetare e kolegjit,

Kimete Veseli

1. Have Haliti

Tonka Berishaj

2. Xhevdet Abazi